40/6 , neni 54, neni 64/c ; ligjin 68/2017 datë 27.04.2017 "Per financat e vetëqeverisjes vendore" neni 4 pika 4; VKB nr.66 datë 26.12.2019 "Per miratimin e buxhetit të vitit 2020 dhe PBA përfundimtare 2020-2022".

**JU RELATOI:**

***Të nderuar Këshilltar !***

Drejtoria e Shërbimit Social, bazuar në situatën aktuale të pandemisë Covid-19 dhe periudha e izolimit social që ka cdo familje, udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar COVID-19, kërkon të mbështesë grupet vulnerabël në Bashkinë Berat, nëpërmjet vënien në dispozicion të shumës 2.000.000 lekë, për plotësimin e nevojave bazike si me ushqime, medikamente të nevojshme dhe materiale të tjera emergjente për të përballuar situatën e krijuar prej virusit. Shuma mësipërme do të përdoret nga fondet e emergjencave bazuar në buxhetin e vitit 2020 të Bashkisë Berat. Shtresat në nevojë, në pamundësi ekonomike do të evidentohet nga Bashkia Berat nëpërmjet patronazhimit prej personave përgjegjës dhe grupeve të terrenit. Njëkohësisht, do të hartohet plani i furnizimit me ushqime, medikamente, detergjent për këto shtresa më qëllim marrjen e masave parandaluese për përhapjen e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

**DREJTORI I SHËRBIMIT SOCIAL**
**Juvina Qevani**

miratimin e "buxhetit të vitit 2020 dhe PBA përfundimtare 2020-2022", në kudër të masave dhe situatës së krijuar, me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar COVID-19,

**PROPOZON:**

1. Miratimin e shumës prej 2.000.000 lekë për të mbështetur shtresat në nevojë, për nevoja bazike për jetesë dhe materiale të tjera për përballimin e situatës emergjente të krijuar.

2. Shuma prej 2000000 (dymilion) lekë të përballohet nga fondi për mbrojtjen civile.

3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Social , Drejtoria e Menaxhimit Finaciar dhe të Ardhurave dhe Drejtoria e Emergjencave Civile, Pronave dhe Transportit.

**KRYETARI I BASHKISË**

**Ervin Demo**

Projektvendimi u pa dhe ka bazueshmëri ligjore .

**JURISTE**
**Nertila Kadëna**

**SEKRETARI I KËSHILLIT**
**Bora Agalliu**